



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 87 Dt. 19/05/25



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafet 1.1, 1.14, 15, 18 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 21, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1, 1.16, 1.17 dhe 1.18 të Statutit të OFK-së nr.134 të datës 17/05/2025, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** raporti i punës dhe raporti financiarë për periudhen raportuese 1 Janar 2024 deri me 31 Dhjetor 2024.
- II. Raporti i punës dhe ai financiar i bashkangjiten këtij vendimi si shtojcë
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I'dërgohen :

- Shëbrimit Profesional të OFK-së
- Për publikim në web

Kryetari i OFK-së

Mr.Ph. Kadri Bytyqi





**ODAE FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA
KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

**AKTIVITETET E
ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2024**

Prishtinë, MAJ 2025

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI	5
EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL	8
Cmimet per punimet me impact faktor te anetareve te OFK-së.....	8
Kongresi me pjesëmarrje ndërkombëtare “Integrimi Farmaceutik në BE - Sfidat Legjislative”G	
Tryezë diskutimi në Ditën Botërore të Farmacisë	G
Aktivitet tjera të EVP-së të akredituara nga OFK	10
MBIKËQYRJA PROFESIONALE – ETIKE E ANËTARËVE TË OFK-SË.....	11
PLOTËSIM / NDRYSHIMI I STATUTIT TË OFK-SË DHE AKTEVE TJERA	12
OFK PJESË E PROJEKTIT "MBËSHTETJE PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE" 1C	
DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE TË OFK-SË.....	17
DISKUTIMET PUBLIKE ME ANËTARËT PËR PROBLEMET E SEKTORIT FARMACEUTIK DHE LOBIMET	18
Diskutimi per rregulloren per kujdestarite e barnatoreve.....	18
Takimet ne DMZP	1G
Lobimi për profilet e reja specialistike për farmacistët	20
MARRVESHJET E BASHKËPUNIMIT	21
Marrvëshja e bashkëpunimit me AKPPM.....	21
Marrvëshja e bashkëpunimit me FSK	21

Marrëveshja e bashkëpunimit me Doganën	22
Takimet e përbashkët të OPSH me qëllim të unifikimit të kërkesave.....	22
Mardhëniet me SHSKUK	24
Takimet me Komisionin parlamentarë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	24
Mardhëniet me Odat e Shteteve të Rajonit.....	25
SFIDAT E PA ZGJIDHUR TË KOMUNITETIT GJATË VITIT 2024	2C
Rregullimi i pronësisë të barnatoreve për farmacistë.....	27
Rregullimi i kriterëve demografike dhe gjeografike për hapjen e barnatoreve të reja.....	27
Orari i punës në nivel nacional për barnatore dhe sigurimi i dy farmacistëve për barnatore	28
Unifikimi i çmimit të barnave	28
Rritja e profileve specialisitike për komunitetin e farmacisë.....	2G
Rritja e numrit të farmacistëve të punësuar në institucione publike shëndetësore	30
Kategorizimi i pagave të farmacistëve të institucionet publike sipas parimit pagë e njëjtë .	30

HYRJE

Të nderuar anëtarë të Kuvendit ,

Gjatë vitit 2024, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka vazhduar punën e saj në bazë të fushëveprimit të përcaktuar me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150.

Viti 2024 për Odën e Farmacistëve të Kosovës, ishte vit i ndryshimit të legjislacionit të saj të brendëshëm, duke filluar nga akti më i lartë i saj, Statutin e OFK-së për të cilin ndryshim jeni njoftuar edhe ju si Ministër i Shëndetësisë, me të cilat ndryshime është bërë decentralizimi i disa kompetencave nga Kryetari i OFK-së te organet tjera të Odës, si dhe janë paraparë mekanizma të ri për inkuadrimin e anëtarëve në vendimarrje e organeve të OFK-së, me qëllim të transparencës së punës së saj dhe gjithpërfshirjes së anëtarëve tanë në vendimarrjen e OFK-së, në mënyrë që vendimet e OFK-së të jenë në përputhje me qëndrimin e anëtarëve të saj.

Viti 2024, për OFK paraqet edhe shëndrrimin e shërbimeve të saj nga ato fizike në platformë elektronike online, ku të gjitha shërbimet administrative të OFK-së tani më merren online nga anëtarët tanë, duke ndikuar në ekonomizimin, lehtësimin e punës së anëtarëve tanë, dhe njëkohësisht duke rritur transparencën e punës së OFK-së. OFK mbetet me shpresë se frymën bashkëpunuese me qëllim të lehtësimit të punës të komunitetit farmaceutik do të gjej edhe nga institucionet tjera që merren me komunitetin farmaceutik me qëllim të ndërlidhjes së këtyre sistemeve mes institucioneve dhe shmangjen e procedurave burokratike sa më shumë që të jetë e mundur në kryerjen e procedurave administrative.

Gjatë vitit 2024, po ashtu kemi nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunuese me disa institucione tjera publike për shkëmbimin e përvojave tona, rritjen e ofrit të shërbimeve shëndetësore farmaceutike dhe monitorimin e punës së anëtarëve tanë, të cilat më në detaje janë të përshkruara në pjesën e përshkrimit të marrëveshjeve në këtë raport.

Në kuadër të fushëveprimit të saj, e me qëllim të krijimit të mundësive për përmbushje ligjore të kushteve të anëtarëve tanë për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore, kemi vazhduar edhe me aktivitet e edukimit të vazhdueshëm profesional të anëtarëve tanë ku Oda e Farmacistëve të Kosovës ka organizuar e akredituar disa aktivitet të edukimit të vazhdueshëm profesional të cilat më në detaje janë të përshkruar më poshtë, dhe ka akredituar disa tjera nga subjektet e tjera të autorizuar për ofrim të EVP-së.

Me qëllim të inkurajimit të anëtarëve tanë për pjesëmarrje në aktivitet shkencore hulumtuese, si OFK kemi financuar edhe punimet më të mira me impact faktor, të përzgjedhur me konkurs publik përmes një komisioni profesional i cili pastaj ka bërë përzgjedhjen e tyre.


Po ashtu, në periudhën e lartëcekur OFK ka vazhduar proceset e zakonshme të aktiviteteve të saj, si anëtarësimet, licencimet dhe rilicencimet, mbikqyrje profesional dhe aktivitetet tjera profesionale e socio - ekonomike të anëtarëve tanë.

ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI

Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150 në kuadër të përgjegjësi dhe kompetencave të Odave të Profesionistëve Shëndetësor ka paraparë edhe kompetencën publike të regjistrimit të profesionistëve shëndetësor, licencimit dhe rilicencimit të tyre.

Gjatë vitit 2024, me qëllim të motivimit dhe përkrahjes të anëtarëve tanë të sapo diplomuar dhe të përfunduar provimin e licencimit, ka vendosur lirim për vitin e parë nga taksa administrative për anëtarësim për të gjithë farmacistët që anëtarësohen brenda 12 muajsh nga periudha e përfundimit të provimit të licencës.

Komisioni i licencimit dhe rilicencimit në periudhën raportuese Janar –Dhjetor 2024, ka shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme



Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
30/01/24	1	0	1	1	0	1	10	17	27

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
23/02/24	4	23	27	4	23	27	8	6	14

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
19/03/24	1	3	4	1	2	3	5	8	13

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total

27/03/24	2	2	4	1	0	1	0	0	0
----------	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
29/04/24	0	1	1	1	5	6	3	7	10

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
22/05/24	1	5	6	1	7	8	1	5	6

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
20/06/24	2	6	8	2	4	6	1	14	15

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
27/07/24	3	6	9	1	6	7	13	9	22

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
19/08/24	2	7	9	2	7	9	7	7	14

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
23/09/24	3	3	6	2	3	5	2	9	11

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
23/10/24	0	4	4	0	4	4	6	5	11

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
--------------	--	--	--	------------	--	--	--------------	--	--

Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
21/11/24	3	4	7	3	3	6	4	5	G

Anetaresimet				Licencimet			Rilicencimet		
Takimi	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total	Mashkuj	Femra	Total
23/12/24	4	3	7	1	4	5	2	13	15

Total anetaresi me	Mashkuj	26	Total Licen cime	Mashkuj	20	Total Rilic enci me	Mashkuj	62
	Femra	67		Femra	68		Femra	105
	Total	93		Total	88		Total	167

EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Odat e Profesionistëve Shëndetësor në kuadër të misionit dhe qëllimit për të cilët janë krijuar, një ndër fushëveprimin kryesor e kanë procesin e edukimit të vazhdueshëm profesional të farmacistëve si parkusht për rilicencimin e tyre.

Në kuadër të kësaj kompetencë dhe detyrimi OFK gjatë periudhës së vitit 2024 ka organizuar disa aktivitete përmes të cilave është realizuar ky proces.

Cmimet për punimet me impact faktor të anëtarëve të OFK-së

Në fund të vitit 2024, OFK ka shpallur konkursin publik për anëtarët e saj për aplikim të të gjithë anëtarëve të cilët kanë punime shkencore hulumtuese gjatë vitit 2024, konkurs ky i cili është organizuar dhe proceduar nga një komision profesional i përbër nga profesor universitar.

Çmimet e ndara ishin në dy kategori, për anëtarët senior dhe për anëtarë junior, kjo me qëllim që mos të dëmtohen anëtarët e ri të cilët sapo kanë hyrë në karrieren akademike shkencore dhe që ky konkurs me fond simbolik të shërbej si motiv për punën e tyre hulumtuese në angazhimet e tyre të ardhëshme. Pas zhvillimit të procedurave të konkursit, përfitues janë shpallur tre anëtarë të Odës.

Kongresi me pjesëmarrje ndërkombëtare “Integrimi Farmaceutik në BE – Sfidat Legjislative”

Në Qershor të vitit 2024, Oda e Farmacistëve të Kosovës në kuadër të autorizime ligjore për edukimin e vazhdueshëm profesional ka organizuar kongresin ndërkombëtar “Integrimi Farmaceutik në BE – Sfidat Legjislative” me pjesëmarrjen e dhjetëra ligjëruesve ndërkombëtar, dhe mijëra farmacistëve ndërkombëtar.

Në këtë kongres u paraqiten dhjetëra punime, që kryesisht kishin për qëllim për të treguar përparësitë e rregullimit farmaceutik në nivel të shteteve të Evropës.

Tryezë diskutimi në Ditën Botërore e Farmacistëve

Në nder të 25 Shtatorit, OFK dhe ShFK mbajten tryezën e diskutimit me temën **“Roli i Farmacistit në Avancimin e Kujdesit Shëndetësor”**

Në tryezë u theksua se farmacistët janë një nga aktorët kyç në sigurimin e kujdesit të duhur dhe menaxhimin e terapisë mjekësore, prandaj edhe avanësimi i tyre në sistem shëndetësor është crucial për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. OFK dhe ShFK veçanërisht falenderuan për kontributin e tyre në këtë debat kolegët drejtues të SHSKUK-së dhe Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të Kosovës.

Nga pjesëmarrësit u kërkua angazhim i aktereve institucional për të promovuar dhe avancuar këtë rol të rëndësishëm, duke bashkëpunuar ngusht me institucione shëndetësore, organizata dhe profesionistë të tjerë.

Objekti i përbashkët i pjesëmarrësve ishte fuqizimi i farmacistëve me rol të fortë në sistemin shëndetësor dhe rritjen e ndikimit të farmacistëve në përmirësimin e shëndetit publik.

Aktivitet tjera të EVP-së të akredituara nga OFK

1. **Fahri Zabërxha B.I ‘Barnatore Tini Pharm- Përdorimi dhe Efektet e produkteve bimore në farmaci, i vlerësuar me 8 pikë për pjesëmarrësit aktiv dhe 5 pikë për pjesëmarrësit pasiv.**
2. **Ecra Pharm-Roli i farmacistit në ofrimin e kujdesit optimal të pacientit. Dhimbja dhe infeksionet e traktit respirator, i vlerësuar me 13 pikë për pjesëmarrësit aktiv dhe 10 pikë për pjesëmarrësit pasiv.**
3. **Qendra Kosovare për Hulumtim Trajnim Dhe Zhvillim të Politikave Sociale dhe Shëndetësore, duke pasur parasysh që aktiviteti është i parapar me 4 module, komisioni vlerësoi se ky aktivitet i plotëson kriteret si : **Kurs i kategorisë I dhe II**
Moduli I-Kurs i kategorisë I- 5 pike pasive, 10 aktive
Moduli II-Kurs i kategorisë II- 3 pike pasive, 6 aktive
Moduli III- Kurs i kategorisë II- 3 pike pasive, 6 aktive
Moduli IV-Kurs i kategorisë II- 3 pike pasive, 6 aktive**
4. **Shoqata e Farmacistëve të Kosovës, Farmacia e ushqimit-Roli i edukimit nutricional ne farmaci, e vlerësuar si Konferencë dhe ëorkshop me 17 pikë për ligjëruesit e ftuar, 15 pikë për pjesëmarrësit aktiv dhe 12 pikë për pjesëmarrësit pasiv.**
5. **Oda e Farmacistëve të Kosovës dhe Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë, Kongresi ndërkombëtar “Integrimi Farmaceutik në BE-Sfidat Legjislative” me ëorkshop duke vlerësuar me 23 pikë pjesëmarrësit pasiv dhe 28 pjesëmarrësit aktiv.**
6. **Kolegji Heimeirer “ Konferenca e 15 ndërkombëtare e shkencave shëndetësore” , e vlerësuar me 17 pikë për ligjëruesit e ftuar, 15 pikë për prezantuesit oral dhe 8 pikë për pjesëmarrësit pasiv.**

7. **Kolegji UBT, Konferenca vjetore ndërkombëtare**, 12 pikë për pjesëmarrësit pasiv, 15 pikë për pjesëmarrësit aktiv, 17 pikë për ligjëruesit e ftuar
8. **Shoqata Brainsorm, Pacienti ne fokus te mjekut dhe farmacistit** e vlerësuar si seminar me 10 pikë për pjesëmarrësit aktiv, dhe 8 pikë për ata pasiv.

MBIKËQYRJA PROFESIONALE – ETIKE E ANËTARËVE TË OFK-SË

Oda e Farmacistëve të Kosovës me qëllim të mbikqyrjes profesionale të anëtarëve dhe shërbimeve farmaceutike, rritjes së sigurisë dhe cilësisë së produkteve farmaceutike, aktualisht ka të nënshkruara disa marrëveshje bashkëpunimi duke përfshir edhe atë me Inspektoriatin Farmaceutik, Agjensionin për Produkte dhe Paisje Medicinale, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe Doganën e Republikës së Kosovës.

Në këtë kuadër organet etike të OFK-së të përcaktuara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150 , Prokurori i Odës, Këshilli Etik dhe Gjyqi i Nderit kanë vazhduar punën e tyre në trajtimin e këtyre lëndëve.

Në këtë kuadër, Këshilli Etik i Odës, ka ftuar në takime të drejtpërdrejta të gjithë anëtarët ndaj të cilëve janë paraqitur raporte inspektuese nga ana e Inspektoriatit Farmaceutik dhe Doganës të Republikës të Kosovës për të marrë pikëpamjen e tyre mbi raportet e paraqitura ndaj tyre, dhe ndaj anëtarëve të njejtë në rastet kur janë gjetur se kanë marrë veprime në kundërshtim me legjislacionin aktual, ka ndërmarrë tërheqjen e vërejtjes dhe shqiptimin e masave disiplinore nën kushtin e ekzekutimit të tërheqjes së licencës për periudhë jo më të vogël se gjashtë muaj në rast se veprimet e të njejtëve përsëriten brenda një viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtyre masave.

Gjithsesi, organet përkatëse etike kanë ruajtur sigurinë juridike të anëtarëve dhe të drejtat e përcaktuara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, respektivisht nenit 37, në të gjitha rastet kur raportet janë paraqitur në periudhë më të largët se një vit nga shkelja e pretenduar apo kur janë cënuar afatet për realizimin e mjeteve juridike, ashtu që procedurën në fjalë ka konstatuar të parashkruara për shkak të tejkalimit të afateve kohore.

PLOTËSIM / NDRYSHIMI I STATUTIT TË OFK-SË DHE AKTEVE TJERA

Në vitin 2023, Këshilli Drejtues i Odës së Farmacistëve të Kosovës ka emëruar një komision të përbër nga farmacist të barnatoreve komunitare, nga institucionet publike shëndetësore si dhe nga ato administrative qendrore, të cilët i ka autorizuar për analizmin e statutit aktual dhe rekomandimeve për nevojën e plotësimit të tij. Iniciativa për ndryshim filloi pasi kishin kaluar pothuajse një dekad nga miratimi i Statutit të OFK-së, i cili veq se kishte realizuar misionin e tij të nxjerrjes për bartjen e kompetencave publike dhe pregaditjen e kuadrit ligjor për bartjen e tyre dhe funksionimin efikas e strukturor të organeve të OFK-së në kuadër të kompetencave të parapra me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor.

Propozimet e nxjerra nga ana e këtij grupi dhe të miratuara nga Këshilli Drejtues, janë paraqitur për dëgjim publik me të gjithë anëtarët e Odës. Dëgjimi Publik përmes faqës së internetit është paraqitur në shkurtin e vitit 2024. Në këtë fazë dokumenti është shpalosur për konsultim publik me qëllim të marrjes së ideve, komenteve dhe rekomandimeve nga opinioni i gjerë, organizatat, ekspertët dhe individët e interesuar e që janë të ndikuar apo janë në relacione bashkëpunimi lidhur me kapacitetet në fushën e shëndetësisë. Hapësira për propozime në faqen e internetit ka qenë nga data 26 shkurt deri me 13 Mars 2024.

dhe komunikimit e debatit ballë
debatet publike të organizuara
debate këto të cilat kanë
OPSH-ve ku aktet e tyre

kryesore hartohen nga vetë

Përveq muneësisë së pranimit të komenteve në faqen e internetit, OFK me qëlim të gjithpërshirjes

për ballë me anëtarët, ka organizuar edhe
nëpër qendrat më të mëdha rajonale,
paraqitur një metodë të re të punës së

propozimet e anëtarëve.

Orari dhe vendet e organizimit të degjimit publik për plotësim ndryshimin e Statutit të OFK				
Qyteti	Data	Ora	Vendi	Salla
1 Prishtinë	12/3/2024	16:00	OFTK - , Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim në QKUK	Kati I-rë
2 Mitrovicë	7/3/2024	15:00	Spitali përgjithshëm	Salla e telemjekësisë
3 Pejë	8/3/2024	14:30	Spitali përgjithshëm	Salla e mbledhjeve të drejtorisë
4 Prizren	9/3/2024	10:00	Spitali përgjithshëm	Instituti I shëndetit publik
5 Ferizaj	6/3/2024	14:30	Spitali përgjithshëm	Salla telemjekësisë
6 Gjiilan	6/3/2024	11:00	Spitali përgjithshëm	Salla e drejtorisë
7 Gjakovë	8/3/2024	11:00	Spitali përgjithshëm	Objekti i kirurgjisë së vjetër - Kati II

Me ndryshimet e reja të statutit i është mundësuar anëtarëve të Odës të japin propozime dhe iniciativa për çështje aktuale në fushën e farmacisë pranë organeve të Odës. Me ndryshimet e Statutit, është bërë përcaktimi taksativ i kompetencave të organeve të OFK-së, duke hequr mundësit për dy kuptimësi në interpretimet e tyre nga të cilat mund të rezultojnë cfarëdo kriza të brendëshme institucionale.

Po ashtu brenda statutit në përputhje me kërkesen ligjore është bërë edhe përcaktimi i sakt i sistemit zgjedhor për Kuvendin, si organin më të lartë të Odës të përcaktuar me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, në të cilën zgjedhen përfaqësuesit e komunitetit farmaceutik dhe janë përgjegjës për zgjedhjen e pothuajse secilit organ tjetër brenda strukturës organizative të OFK-së, dhe gjithashtu me qëllim të krijimit të mundësive të gjithpërshirjes së anëtarëve në Kuvend është përcaktuar tashmë se anëtarët e Kuvendit nuk mund të ushtrojnë radhazi më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

Për herë të parë, në statutin e OFK-së janë përcaktuar edhe rastet kur një anëtar i Kuvendit përfundon mandatin edhe para kohës së rregullt të mandatit, ku janë vendosur kritere për ruajtjen e kredibiliteti dhe integritetit përfaqësues insititucional duke vendosur kritere të humbjes së statusit të anëtarit edhe tërheqjen e licencës për tre apo më shumë vite edhe vendimet e plotëfuqishme gjyqësore për dënim me burgim.

Po ashtu, OFK është ndër të vetme Oda, e cila i ka krijuar mundësinë anëtarëve të saj që me iniciimin e numrit të caktuar të anëtarëve të përgjithshëm, të fillojnë procedurën e realizimit të mocioni të mosbesimit ndaj kuvendit të OFK-së, i cili mocion nëse rezulton i sukseshëm ka për pasojë përfundimin e mandatit para kohe dhe zgjedhjen e Kuvendit të ri përmes procesit të ri zgjedhor.

Statuti i OFK-së ndër të tjera ka rregulluar edhe punën dhe mënyrën e thirrjes së Kuvendit si organi më i lartë dhe përfaqësues i farmacistëve, duke eliminuar çfardo krize hipotetike përmes ofrimit të zgjidhjeve dhe alternativave për funksionim normal dhe të pa penguar të tij.

Ndër risit kryesore të Statutit të ri, është tendenca e decentralizimit të kompetencave të Kryetarit të OFK-së të cilat me statutin e vjetër i njiheshin një autoritet të gjërë dhe kompetenca të shumta duke e njohur si drejtues të tri organeve kryesore të OFK-së si Këshilli Drejtues dhe Kuvendi. Me statusin e ri tashmë është krijuar edhe Kryesuesi i Këshillit Drejtues, i cili sipas statutit të ri zgjedhet një nga pesë anëtarëve e Këshillit Drejtues të cilët vijn nga radhët e Kuvendit të OFK-së të zgjedhur nga Këshilli Drejtues, përmes të cili mekanizëm është pamundësuar zgjedhja e Kryetarit të OFK-së apo zv. Kryetarëve për Kryesues të Këshillit, duke ndikuarkështu që të rritet përgjegjësia insitucionale dhe të krijohën mekanzima të vecantë punues që nuk janë të ndërlidhur me fushveprimin e Kryetarit dhe Zv. Kryetarëve të OFK-së.

Statuti i miratuar në vitin 2024, përcakton në mënyrë të detajuar jo vetëm mënyrën e zgjedhjes së organeve të OFK-së por edhe procedurën e shkarkimit të këtyre organeve duke filluar nga Kryetari i Odës dhe vetë Kuvendi i OFK-së, cka me statusin paraprak nuk ishte e shtjelluar fare procedura e shkarkimit të shumicës së organve.

Me statusin e ri po ashtu përcaktohet se anëtarët e Këshillit Drejtues, nuk kanë të drejtën e emërimit në komisionet e përhershme të Odës, përmes të cilët kufizim është menduar krijimi i mundësive për anëtarët e rij në organet e OFK-së duke eliminuar kështu çfardo keqpërdorimi të mundëshëm të fuqisë së anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Për herë të parë në statutin e ri, janë përcaktuar afatet kohore të konkretizuara për procedurat etike të cilat përcaktohen nga Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, duke rritë sigurinë juridike të anëtarëve tanë pavarësisht nga pozita e tyre që mund të kenë apo njohuritë juridike që posedojnë.

Marrë parasysh numrin e vogël të farmacistëve në kuadër të insitucioneve shëndetësore publike dhe në ato administrative, me statutin e miratuar janë krijuar edhe dy komisione të përkohëshme që i referohen këtyre kategorive, në mënyrë që të njejtat të jenë të përfaqësuar në strukturën organizative të OFK-së pavarësisht numrit të tyre, të cilat komisione kanë rol këshilldhënës për Këshillin Drejtues në lidhje me politikat e ndjekura qëndrore në raport me fushëveprimin e tyre përfaqësues në institucionet publike.

Një rëndësi të veçantë Statuti i miratuar, i ka kushtuar transparencës dhe gjithpërfshirjes së anëtararëve në vendimarrjen e strukturave të OFK-së duke përcaktuar obligimin ligjor për nxjerrjen e rregullorës mbi procedurat për nxjerrjen e akteve juridike të cilat prekin interesin e përgjithshëm të komunitetit, në të cilën përcaktohet forma e realizimit të debatit publik dhe procedurat tjera që duhet të zbatohen për gjithpërfshirjen e anëtarëve në vendimarrje. Statuti i ri, ka filluar së zbatuari nga Qershori i vitit 2024.

Pas miratimi të Stautit, OFK ka miratuar edhe një pako ndryshimesh ligjore të miratuar në Kuvendin e saj, si :

9. Kodin etik
10. Rregullorën për anëtarësim
11. Rregullorën për licencimin dhe rilicencimin e farmacistëve
12. Rregullorën për edukimin e vazhdueshëm profesional
13. Rregullorën për menaxhimin financiare
14. Rregullorën për prokurorim
15. Rregullorën për për hartimin dhe debatin publik të akteve normative të Kuvendit
16. Rregullorën për dekorata dhe cmim

17. Rregullorën për punën e organeve kolegjiale

18. Rregullorën për zgjedhje

OFK PJESË E PROJEKTIT "MBËSHTETJE PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE"

Zv. Kryetarja e OFK-së znj. Jehona Hakaj ka qenë pjesë e programt të financuar nga Bashkimi Evropian i cili ka për qëllim përgaditjen e institucioneve për zbatimin e marrëveshjes së Berlinit nga Qeveritë e shteteve nënshkruese dhe ndër të tjera ka për qëllim kryesor përgaditjen e infrastrukturës ligjore në harmoni me direktivat e BE-së në fushën e kualifikimeve profesionale dhe njohjeve reciproke të tyre, lehtësimin e ushtrimit të profesionit në shtetet nënshkruese pa ju nënshtruar procedurave burokratike duke njohur exoficio të drejten e ushtrimit të profesionit në shtetet nënshkruese.

Përmes këtij projekti, po vendoset një gurthemel i qëndrueshëm duke siguruar që profesionistët kosovarë- si: mjekët, arkitektët, mjekët veterinerë, farmacistët, stomatologët, infermierët, mamitë

apo profesionistë tjerë, mund të kenë kualifikimet e tyre të njohura si në vendet e Ballkanit ashtu edhe në gjithë Evropën pas anëtarësimit në BE. Kjo do t'ju mundësojë të ushtrojnë profesionet e tyre dhe të punojnë në vendet fqinje ose në vendet e BE-së, kur ne të jemi vend anëtar.

Ne veçanti gjatë këtij projektit janë shkëmbyer përvojat e shteteve evropiane të cilat kanë treguar për praktikën e tyre të licencimit profesional e cila në tërësi zhvillohet te odat e profesionistëve shëndetësor duke filluar nga praktika profesionale, provimet e licencave, edukimi i vazhdueshëm profesional, rilicencimi, mbikqyrja profesionale si dhe organizimi dhe mbikqyrja e shkollimit specialistik të profesionsitëve shëndetësor, ku si të tilla janë konsideruar si praktika të domosdoshme të cilat duhet ndjekur nga të gjitha shtet si praktikë efikase me ndikim në sigurimin e shërbimeve profesionale shëndetësore.

Në fund të programit znj. Hakaj është certifikuar si trajner në kuadër të temës së këtij programi.

DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE TË OFK-SË

Oda e Farmacistëve të Kosovës në fund të vitit 2024, me qëllim të lehtësimit të punës së anëtarëve të saj, në kuadër të shërbimeve administrative ka lanësuar platformën digjitale për anëtarë.

Në kuadër të platformës do të ofrohen shërbimet për :

- anëtarësim,
- licencim dhe rilicencim
- valorizim, edukim të vazhdueshëm profesional
- si dhe realizimin e kërkesave tjera të nevojshme për anëtarët e saj

Nga nëntori 2024, shërbimet të cilat deri më tani kemi pasur mundësinë t'i ofrojmë vetëm në formë fizike, anëtarët e OFK-së mund ti merreni vetëm përmes platformës digjitale.

Kjo platformë letëson edhe punën e organeve monitoruese të shërbimeve shëndetësore, të cilat origjinalitetin dhe validitetin e dokumenteve të profesionsitit shëndetësor mund ta verifikojnë direkt nga platforma përmes QR Codit në ID Kartelën e anëtarit apo Licencën e tij.

Ky projekt është financuar nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luxemburgut

DISKUTIMET PUBLIKE ME ANËTARËT PËR PROBLEMET E SEKTORIT FARMACEUTIK DHE LOBIMET

Diskutimi per rregulloren per kujdestarite e barnatoreve

Pas vlerësimit të rregullorës të Komunës së Prishtinës si jo në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe kthimit të saj në rishqyrtim në Komun, duke konsideruar si të drejta pretendimet e OFK-së të ngritura ndaj ligjshmërisë së rregullorës së Komunës së Prishtinës me të cilin preket orari i barnatoreve në Prishtinë, Kryetari i OFK-së z. Kadri Bytyqi, së bashku me zv. Kryetarët znj. Hakaj dhe z. Haxhijaha si dhe anëtarin e Këshillit Drejtues z. Fatos Aliu, ka mbajtur debat

publik me farmacistët e Komunës së Prishtinës për të bashkrenduar qëndrimet të cilat do të mbajmë gjatë këtij procesi si përfaqësues të farmacistëve.

Farmacistët edhe njëherë shpërfaqen gadishmërinë e tyre profesionale për ta ndihmuar komunën e Prishtinës në realizimin e këtij procesi dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarë 24 orë sipas orarit të përcaktuar përkundër se të njejtit nuk janë përgjegjës për këtë, dhe nuk kanë asnjë lehtësim të ushtrimit të veprimtarisë në komunë.

Për mbarvajtje të këtij procesi, Farmacistët kërkuar angazhim e gadishmëri reciproke e maksimal të organeve komunale në monitorimin dhe inspektimin e këtij procesi pasi shprehen zhgënjimin e tyre të thellë me mosefikasitetin e neglizhencën e organeve lokale në monitorim e plotë të orarit,

veqanarisht me mospërfilljen e orarit të vendosur me vullnetin e tyre gjatë dy – tri javëve të fundvitit 2023, neglizhencë kjo e cila me apo pa qëllim po ndikon në përcëptimin e opinionit se orari i kujdestarive është e pamundur të ekzistojë dhe të mbahet.

Farmacistët e pranishëm kërkuar reflektim të organeve lokale përball kërkesave të tyre, duke u zotuar se mos përfillja e tyre do të hasë në rezistencën e tyre përkatësisht ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore deri në realizimin e këtyre të drejtave ashtu siq vepruan me kundërligjshmërinë e rregullorës, kundërligjshmëri kjo e cila është vërtetuar nga MAPL si organ kompetentë për mbikqyrjen e ligjshmërisë së akteve të Komunës.

Në unanimitet të plotë nga të gjithë, u kërkua nga institucionet përgjegjëse rregullimi i orarit të barnatoreve në nivel nacional si imperativ i kohës. Kryetari i OFK-së Kadri Bytyqi para anëtarëve deklaroi se zëri i tyre i shfaqur në këtë takim është detyrim i krijimit të qëndrimit të OFK-së pranë organeve kompetente për këtë çështje, për të cilat OFK do të jetë e pakompromis në mbrojtjen e tyre. Farmacistët e pranishëm me propozimet e tyre krijuan edhe një grup punues i cili do të adresojë të gjitha problemet e hasura në orarin e kujdestarive në Prishtinë.

Takimet në DMZP

Në këtë takim me zv. Ministrin Dobra, Kryetari i OFK-së paraqiti shqetësimet e farmacistëve të punësuar në institucionet publike, lidhur me sfidat e tyre të ndërlidhura me kategorizimin në kuadër të ligjit të pagave, shtesat ligjore për farmacistët me karrierë vetëm në sektorin publik, si dhe respektimin e parimeve bazë të ligjit, përfshirë parimin e ligjshmërisë, barazisë, dhe mosdiskriminimit duke kërkuar kategorizim sipas parimit pagë e njëjtë për pozitë të njëjtë pavarësisht profilit shëndetësor.

Zv. Ministri Dobra dhe z. Bytyqi sqaruan rrugët ligjore që duhet të ndjekin farmacistët në këto institucione për të realizuar të drejtat e tyre sipas Ligjit për Paga. Ata shprehën të gatshëm për t'u ofruar këshillim në lidhje me procedurat për realizimin e këtyre të drejtave. Gjithashtu, njoftuan se Ministria e Punëve të Brendshme tashmë ka njoftuar institucionet punëdhënëse të profesionistëve shëndetësor për hapat të cilat duhet të ndërmerren për të evituar dhe përmirësuar lëshime eventuale në kategorizim, megjithatë, ata ende nuk kanë marrë përgjigje nga ana e tyre.

Lobimi për profilet e reja specialistike për farmacistët

Kryetari i OFK-së z. Kadri Bytyqi, ka zhvilluar takim të përbashkët me z. Agon Dobruna zv. Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve në Republikën e Kosovës.

Gjatë takimit është shqyrtuar kërkesa e dalura nga takimet paraparake me anëtarët e bordit për edukim specialistik dhe palët tjera lidhur me mundësitë për ngritjen e fondeve buxhetore të cilat do të ndikonin në rritjen e numrit të specializantëve të cilët do të ndahen për profilin e farmacisë, për të eliminuar sadopak diskriminimet e derimëtanishme që janë bërë sa i përket numrit dhe profilit të parapra për shkollim specialistik nga farmacistët.

OFK ka ofruar arsyetimet përkatëse për kërkesat, nevojat dhe benefitet të cilat i ka Republika e Kosovës nga ngritja e kapaciteteve humane në fushën e profileve specialistike të farmacisë.

Në këtë kuadër dhe me qëllim të krijimit të mudnësive për praktikën profesionale për profile të caktuara OFK ka siguruar edhe marrëveshjen e bashkëpunimit me Odën e Farmacistëve të

Maqedonisë për shkëmime profesionale në kuadër të profileve specialitike me qëllim të kryerjes së stazhit të specialistëve jashtë Republikës së Kosovës, për përmbushjen e obligimeve të shkollimit specialistik për anëtarët të cilët janë duke ndjekur shkollimin në Republikën e Kosovës.

MARRVESHJET E BASHKËPUNIMIT

Oda e Farmacistëve të Kosovës gjatë vitit 2024, ka formalizuar disa marrëveshje bashkëpunimi duke përfshirë ato me Agjensionin Kosovar për Produkte dhe Paisje Medicinale, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Doganën e Republikës së Kosovës, Odën e Farmacistëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut etj.

Marrvëshja e bashkëpunimit me AKPPM

Përmes kësaj marrëveshje përcaktohet ngritja e bashkëpunimit në çështjet me interes të përbashkët me theks të veçantë në shkëmbimin e të dhënave nga sistemet nën përgjegjësinë e tyre për farmacistët e licencuar, barnatoret dhe subjektet tjera farmaceutike të licencuara dhe verifikimin e çështjeve nga fushëveprimi i tyre si parakusht për ushtrimin e veprimtarisë së farmacistit si profesionistë shëndetësor.

OFK dhe AKPPM si dy shtëpi në shërbim të farmacistëve u zotuan se do të ndjekin politika të përbashkëta drejt avanësimit të profilit të farmacistit si profesionistë shëndetësor dhe farmacisë në përgjithësi.

Marrëveshja e bashkëpunimit me FSK

Përmes kësaj marrëveshje OFK do ti ofrojë FSK-së të gjithë kuadrin e saj profesional në gatishmëri për çështjet nga fushëveprimi i farmacisë me qëllim të sigurimit të shërbimit sa më cilësorë për nevojat ushtarake të FSK-së.

FSK në anën tjetër do të fillojë pregaditjet për krijimin e kuadrove të reja të specializimeve të veqanta ushtarake të farmacistëve të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të Forcës së Sigurisë të Kosovës ashtu siç është rregulluar në shumë shtete evropiane.

OFK shprehu gadishmërinë, që do të jetë përherë në shërbim profesional të FSK-së drejt realizimit të misionit të saj për mbrojtjen dhe sigurinë e atdheut.

Marrëveshja e bashkëpunimit me Doganën

Ky partneritet synon të forcojë bashkëpunimin midis dy institucioneve dhe të forcojë masat për të garantuar sigurinë publike. Memorandumi i Mirëkuptimit synon të nxis shkëmbimin e informacionit, përvojave dhe njohurive, përmes pikës së caktuar të kontaktit. Konfiskimet e bëra nga Dogana e Kosovës nuk synojnë vetëm kontrabandistët, por synojnë edhe parandalimin e shpërndarjes së barnave të pakontrolluara dhe potencialisht të rrezikshme në treg.

Duke e njohur rëndësinë e llogaridhënies brenda profesionit farmaceutik, Dogana e Kosovës zotohet të informojë me kohë Odën e Farmacistëve për çdo parregullsi apo rast të kontrabandës që përfshin profesionistë të farmacisë. Kjo qasje bashkëpunuese e fuqizon Odën e Farmacistëve për të ndërmarrë masa disiplinore, duke përfshirë gjokat ose revokimin e licencave, ndaj farmacistëve përgjegjës, duke zbatuar qasje gjithëpërfshirëse për të luftuar kontrabandën me barëra nga shumë kënde ligjore.

Oda e Farmacistëve të Kosovës përmes këtij memorandum zotohet për vënjen në gadishmëri të të gjitha kapaciteteve profesionale në hartimin e ekspertizave në fushën e sektorit të farmacisë për nevojat e Doganës së Kosovës. Duke nxitur një komunitet bashkëpunues dhe vigjilent, Dogana e Kosovës dhe Oda e Farmacistëve të Kosovës janë të bashkuar në luftën kundër aktiviteteve të paligjshme që rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë publike në njërin anë dhe padrejtësisht dëmtojnë profesionistët e përgjegjshëm.

Takimet e përbashkët të OPSH me qëllim të unifikimit të kërkesave

Takimet e përbashkëta të Kryetarëve të OPSH-ve u fokusuan në veçanti mbi planin legjislativ të Ministrisë së Shëndetësisë për projektligjet e parapara për hartim gjatë vitit 2024, duke kërkuar që legjislacioni me impakt në sektorin shëndetësor dhe në punën e profesionistëve shëndetësorë të

propozohet nga vetë profesionistët shëndetësorë si palë të interesit ashtu siq veprohet në praktikat demokratike të Evropës.

Odat e Profesionistëve Shëndetësor duke rikujtuar se bashkrendimi me profesionistë shëndetësorë gjatë hartimit të legjislacionit është parakusht për zbatimin praktikë të tyre, shprehen edhe njëherë përkushtimin dhe gadishmërinë e tyre, për mbështetjen e institucioneve vendimarrës në çështjet profesionale ashtu sic është e përcaktuar me Ligjin e Odave të Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150.

Po ashtu gjatë takimit të përbashkët të zhvilluar në tetorin e vitit 2024, kanë analizuar në parim draftin e ligjit për shëndetësi të dërguar dje nga Ministria e Shëndetësisë. OPSH njëzëri kanë konstatuar se që nga takimi i grupit punues për plotësim/ndryshimin e Ligjit për shëndetësi 04/L-125 në Prizren, Qershor 2022, ne si anëtarë të këtij grupi punues, asnjëherë nuk jemi ftuar dhe as konsultuar fare për këtë draft të projektligjit, duke shmangur kështu obligimin ligjor nga MSH, për përfshirje të OPSH-ve në këtë proces.

Ky draft ligj, paraqet tendencë të hapur për centralizim të kompetencave aktuale të cilat tashmë paraqesin ndër sukseset dhe reformat më të mëdha në sistemin shëndetësor të pasluftës duke mundësuar vetëadministrim të profesionsitëve shëndetësor përmes odave përkatëse sipas praktikave të shteteve të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm.

Një tendencë e tillë centralizuese është në kundërshtim të plotë me të gjitha standardet evropiane, dhe si e tillë është e shprehur vetëm në shtetet si Bjellorusia, Hungaria, Turqia dhe Sllovakia.

Vetë draft ligji është në kundërshtim edhe me programin e qeverisë aktuale, në të cilën parashihet rritja e nivelit të bashkëveprimit mes Qeverisë me Odat e Profesionistëve Shëndetësor.

Përmbajtja e këtij draft ligji është në kundërshtim me parimet kushtetuese, ligjin për odat e profesionsitëve shëndetësor, ligjin për zyrtarë publik, ligjin e punës, ligjin për produkte dhe pajisje medicinale, ligjin për prokurimin publik. OPSH kanë formuar grup punues për të analizuar përmbajtjen dhe për të dalur me rekomandime dhe komente konkrete për përmbajtjen e këtij draft ligji.

Mardhëniet me SHSKUK

Kryetari i OFK-së z. Kadri Bytyqi i shoqëruar edhe nga zëvendës kryetarët e OFK-së kanë zhvilluar takim të përbashkët me Drejtorin e SHSKUK-së ,kolegun z. Elvir Azizi.

Bashkarisht është diskutuar mbi pozitën e farmacistëve në sektorin publik dhe mundësitë e bashkpunimit ndërinstitucional me qëllim të përmirësimit të pozitës së farmacisë në sistem shëndetësorë.

z. Bytyqi dhe z. Azizi u dakorduan që bashkarisht të organizohet programe të edukimit të vazhdueshëm për profile specifike të farmacisë me qëllim të avanësimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe avanësimit profesional të farmacisë.

Takimet me Komisionin parlamentarë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Takimet e përbashkëta të OPSH-ve me Komisionin, në temë boshte kishte implementimin dhe zbatimin e Ligjit për Odat Profesionistëve Shëndetësore nr. 04/L-150.

Bashkarisht nga të gjitha odat u ngritën shqetësimet në lidhje me kompetencën e mbikqyrjes së praktikës profesionale për studentet e sapodiplomuar, shkollimin specialistik dhe organizimin e tij

në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore dhe me theks të veçantë, Odat e Profesionistëve Shëndetësor ngriten shqetësimin për bashkpunimin aktual me Ministrinë e Shëndetësisë në fushën e hartimit të legjislacionit duke vlerësuar në pikën më të ulët deri më tani.

Nga ana e anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi, u shfaq interes për dëgjimin e këtyre problematikave duke zotuar se Odat do të kenë përkrahjen e tyre për iniciativat dhe realizimin e kompetencave të tyre ligjore në komision.

Në takimet veçmas të OPSH të zhvilluara me Komsionin, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150. theks të veçant ju kushtua praktikës profesionale, provimit të licencimit dhe çështjes së specializimeve për profilet farmaceutike.

Veqmas në takim u prezantua shqetësimi i komunitetit farmaceutik, për hartimin e legjislacionit nga politkëbërësit pa përfshirë anëtarëve të OFK-së duke bërë që gjatë këtij hartimi të mos përfaqësohen interesat e farmacistëve si profesionistë shëndetësorë

Mardhëniet me Odat e Shteteve të Rajonit

Edhe gjatë vitit 2024, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka vazhduar ruajtjen dhe avanësimin e mardhënieve me odat nga shtetet e rajonit, vecanarisht në aspektin e organizimit dhe sigurimit të programeve përmbajtëse për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional me qëllim të avanësimit dhe përparimit të njohurive profesionale të antarëve të Odës dhe sigurimin e shërbimeve cilësore shëndetësore.

Në këtë drejtim OFK dhe Urdhëri i Farmacistëve të Kosovës kanë bashkëpunuar në organizimin e dy aktiviteteve të mëdha të EVP-së si konferenca mbarëkombëtare "Së bashku për farmaceutiken" e cila do të mbahet me 12 dhe 13 Prill në Tiranë dhe kongresin farmaceutik "Integrimi farmaceutik në BE- Sfidat legjislative" me 1 dhe 2 Qershor në Prishtinë.

Në kongresin "Integrimi farmaceutik në BE- Sfidat legjislative", rol të veçantë kanë luajtur edhe nga Odat e Republikës së Maqedonisë Veriore, Malit të Zi dhe Kroacisë, Bosnjës etj.

Bashkë me Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë është arritur edhe dakordimi për botimin e Revistës Mbarëkombëtare Farmaceutike Shqiptare si dhe hartimin e strategjisë së përbashkët që do i propozohet organeve ligjëbërëse të Shqipërisë dhe Kosovës mbi përmirësimin e legjislacionit farmaceutik

Me Odën e Farmacistëve të Maqedonisë e në prezencën edhe të vetë Ministrit të Shëndetësisë Dr. Arben Taravari, është arritur marrëveshje midis krerëve të dy institucioneve me të cilën do të mundësohet farmacistëve nga Republika e Maqedonisë të njihen pikët e EVP-së të mbajtura në Kosovës dhe anasjelltas.

Pjesë e draftit të marrëveshjes është edhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikës profesionale veqanarisht për profile specifike të specializimeve në Farmaci. Të krerët institucional në këtë marrëveshje shprehen përkushtimin dhe gadishmërin e tyre për shkëmbimin e përvojave të të dy palëve për zgjidhjen e problematikave profesionale në Farmaci.

Me ftesen e Odës së Farmacistëve të Kroacisë, OFK e përfaqësuar nga Kryetari Bytyqi ka prezantuar të arriturat në 10 vjeqarin e funksionimit të OFK-së si dhe gjendjen e sektorit farmaceutik në Republikën e Kosovës duke theksuar veqanërisht pronësinë e barnatoreve, kriteret demografike dhe gjeografike për hapjen e barnatoreve të reja, numrin e vogël të farmacistëve të punësuar në sektorin publik, ndarjen e specializimeve për farmacistë duke theksuar nevojën për rikthimin e biokimisë klinike si profil specialistik për farmacistë, problematikën e shkaktuar me Ua për lehtësimin e procedurave për import të produkteve pa paralel, si dhe çështja e marzhave të çmimeve dhe tarifa e dispenzimit për farmacistë për shërbimet profesionale të tyre.

Kryetari Bytyqi për këto tema, kërkoj nga kolegët nga shtetet tjera shkëmbimin e përvojave dhe njohurive në mes tyre për temat e lartëcekura të cilat paraqesin brenga kryesore të anëtarëve të OFK-së.

SFIDAT E PA ZGJIDHUR TË KOMUNITETIT GJATË VITIT 2024

Anëtarët e Odës së Farmacistëve të Kosovës tash e disa vite janë duke u ballafaquar me disa sfida, zgjidhja e të cilave është kruciale dhe imediale për një funksionim normal të sektorit farmaceutik e rrjedhimisht për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore farmaceutike e cila në hallkën e fundit prek edhe shëndetin publik të qytetarëve.

Si sfida të identifikuar, e për të cilat duhet të punohet në vitet pasuese për zgjidhjen e tyre konisderohen :

Rregullimi i pronësisë të barnatoreve për farmacistë

Rregullimi i pronësisë së barnatoreve, si pronësi vetëm për farmacist apo ku farmacisti gëzon të paktën 50.01 % të aksioneve është një ndër kërkesat e kahmotshme të sektorit tonë, realizimi i të cilës do të kishte impakt në eliminimin e shumë dukurive të cilat janë duke ndodhur në treg në shumicën e rasteve në barnatoret ku pronarët nuk janë farmacist por që barnatoren e kanë si synim

biznesorë dhe jo si institucion shëndetësorë. Një rregullim i tillë tashmë është në shumë shtete evropiane, dhe edhe nga vetë gjykata ndërkombëtare e drejtësisë në gjykimin e disa rasteve është konsideruar si e drejtë e cila nuk cenon të drejtave të njeriut por përkundrazi është në favor të shëndetit publik

Rregullimi i kriterëve demografike dhe gjeografike për hapjen e barnatoreve të reja

Një kërkesë tjetër e kahmotshme e sektorit tonë, e cila nuk ka gjetur zgjidhje janë edhe vendosja e kriterëve demografike dhe gjeografike për hapjen e barnatoreve. Tashmë jemi dëshmitar të kaosit e cila është shkaktuar si pasojë e hapjes së barnatoreve pa asnjë kriter gjeografik e demografik. Aktualisht në Republikën e Kosovës kemi rreth 850 barnatore, apo një barnatore për çdo 1900 banorë, e cila statistikë është kundër praktikës të shteteve evropiane ku synojmë të integrohemi, e e cila statistikë po ndikon edhe në konkurrencën e padrejtë e cila nuk po bazohet në shërbimin profesional por në atë përfitues biznesore, veçmas kur shtohet edhe fakti i mos rregullimit të pronësisë për farmacistë. Prandaj në ndryshimet legjislativë gjatë viteve të radhës, është imediate përfshirja e këtyre propozimeve në legjislacion për rregullimin e tregut farmaceutik.

Orari i punës në nivel nacional për barnatore dhe sigurimi i dy farmacistëve për barnatore

Përkundër se disa komuna tashmë kanë rregulluar orarin e funksionimit të barnatoreve në nivel komunal, komuniteti farmaceutik vazhdimisht ka kërkuar që rregullimi i funksionimit të orarit të bëhet në nivel nacional për të gjithë shtetin.

Me orarin nacional do të eliminohej cfardo praktike diskriminuese e cila ndodh sot në mes orareve në komuna të ndryshme, të cilat sfidohen nga orari i komunës së afërt i cili mund të jetë më i gjatë dhe në këtë mënyrë të dëmtojë funksionimin e mirëfillët profesional të barnatores . Një orar i till nacional është i domosdoshëm vecanrisht për qytet rajonale ku janë të fokusuara shërbimet dytësore dhe ato terciare shëndetësore.

Po ashtu për të siguruar kontinuitetin e shërbimeve shëndetësore farmaceutike, Ministria e Shëndetësisë në ndryshimet ligjore duhet të përfshijë edhe obligimin e deklarimit të orarit të punës për barnatore dhe farmacistin si dhe në të gjitha rastet e tejkalimit mbi 8 orë të përcaktohet obligimi për sigurimin e punës për farmacistin e dytë që do të jetë përgjegjës për këtë orar.

OFK do të jetë përkrah Minsitrisë së Shëndetësisë në përkrahjen dhe kontributëdhënien në këto ndryshime legjislative

Unifikimi i çmimit të barnave

Unifikimi i çmimit të barnave është kërkersa kryesore dhe imediate e kërkuar nga farmacistët që nga paslufta në Kosovë. Megjithëse ky proces ka filluar implementimin e tij gjatë vitit 2024, në zbatimin praktikë janë hasur në shumë probleme të cilat vetëm se e kanë rënduar pozitën e farmacistëve dhe funksionimin e barnatoreve.

Ndër problemet kryesorë të këtij procesi për komunitetin farmaceutik pa dyshim se janë marazhat e vogla të parapara për barnatore ku 92 % e anëtarëve tanë ushtrojnë veprimtarinë e tyre , mos përfshirja e tarifës së dispensimit për shërbimin shëndetësor të farmacistëve ashtu siq

është praktika e të gjitha shteteve, dhe veqmas rëndesa shtesë e anëtarëve tanë me barra për vendosjen e cmimeve në produkte për kundër se rregullimi ligjorë përcakton subjekte tjera për këtë proces.

Prandaj komuniteti farmaceutik mbete me shpresen në zgjidhjen e këtyre problemeve që janë hasur në mënyrë që të realizohet në praktikë kërkesa kryesore e komunitetit ton me të cilën do të bëhej e mundur që barnatoret të njihen vetëm mbi funksionimin dhe këshillimin profesional pa pasur nevojë të shihet kosto ekonomike e produktit.

OFK dhe komuniteti farmaceutik janë në gadishmëri të përhershme për këto ndryshime të cilat do ta vënin në zbatim praktikë unifikimin e cmimeve e cila si e tillë është kërkesë e kahmotshme e komunitetin tonë në mënyrë që të njejtet gjatë veprimtarisë të fokusohen vetëm në shërbimet profesionale

Rritja e profileve specialisitike për komunitetin e farmacisë

Ndryshimet e udhëzimeve administrative për shkollim specialistik kanë prekur interest e komunitetit tonë, ku disa profile të cilat funksionojnë në shtetet evropiane si profile edhe të farmacisë janë hekur me ndryshimet e ndodhura legjislative gjatë dekadës së fundit. Si rast të tillë kemi biokiminë, i cili profil specialistik tash e një dekadë po i pamundësohet anëtarëve tanë ta ndjekin në kuadër të shkollimit specialistik.

Prandaj, është e domosdoshme që në kuadër të ndryshimeve legjislative Ministria e Shëndetësisë të marr hapa në drejtim të zgjerimit të korpusit të profileve specialisitike për farmacist duke përshtatur kështu me trendet dhe drejtimet e shteteve evropiane të profileve që i ofrojnë për profil të farmacistit.

Rritja e numrit të farmacistëve të punësuar në institucione publike shëndetësore

Për kundër obligime ligjore të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L-125 në nenin 26, paragrafi 2 "*Barërat e përshkruara nga mjeku ose stomatologu mund të jepen vetëm nga ose në prezencë të farmacistit të licencuar*", jemi dëshmitarë se ky obligim nuk përmbushet nga ana e vetë institucioneve publike.

Përgjashtimisht QKMF, janë të rralla rastet e punësimit të farmacistit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Edhe në insitucionet parësore, dytësore e tretësore të cilat kanë farmacistë të punësuar, numri tyre është po thuajse i pa përfillshëm duke qenë larg standardeve për sigurimin e mirëfilltë dhe të sigurt të shërbimeve shëndetësore. Prandaj, ndërmmarrja e politikave në drejtim të rritjes së numrit të farmacistëve të punësuar në insitucionet shëndetësore duhet të jetë prioritet i politikave shëndetësore nga e cila varet edhe vetë siguria e produkteve farmaceutike dhe sigurimi për marrjen e rregullt dhe në diagnozën e duhur të këtyre produkteve nga qytetarët.

Kategorizimi i pagave të farmacistëve të institucionet publike sipas parimit pagë e njëjtë

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga nr. 08/L-196, është ndryshuar kategorizimi i pagave, me c'rast në praktikë është shkaktuar një kaos i vërtet për profilet e farmacisë vecmas ata të cilët ushtrojnë profesionin në kuadër të nivelit parësorë të kujdesit shëndetësor, ku për punën e njejtë klasifikohen në kategori të ndryshme nga komuna në komunë.

Një praktikë e tillë është diskriminuese dhe nuk inkurajon punën e baranartë dhe zhvillimin e karrierës përkatësisht dëshirës së avanësimit në këto insitucione. Praktika e tillë është edhe te insitucionet e nivelit dytësorë e tretësorë, ku për kundër shkollimit dhe pregaditjes specialistik janë klasifikuar në një kategori me magjistra të farmacisë.

Prandaj, me qëllim të zbatimit të parimit të barabartësisë si dhe mos diskriminimit ministria e punëve të brendshme së bashku me insituiconet punëdhënëse duhet të punojë për eliminimin e këtyre praktikave dhe sigurimin e zbatimit të parimit pagë e njejtë për pozitë të njejtë që ka qenë vetë parim themelorë i Ligjit për paga.

Kjo dukuri është ngrit disa herë në organet përkatëse nga OFK, por përkundrazi nuk ka gjetur zgjidhje gjatë vitit 2024 për kundër gadishmërisë që kishte DMZP.

KËTIJ RAPORTI I BASHKANGJITEN RAPORTET MUJORE TE MIRATUARA NE KESHILLIN MBIKQYRËS

KRYETARI I OFK-SË

Mr. Ph. Kadri Bytyqi

RAPORTI I PUNËS TË ORGANEVE TË OFK-SË JANAR 2024

Këshilli Drejtues		DATË: 11/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Kadri Bytyqi - Kryetar 2. Jehona Hakaj – zv. Kryetare 3. Astrit Haxhijaha – zv. Kryetar 4. Ismail Shurdhaj – anëtar 5. Jeton Gutaj – anëtar 6. Visar Ademi – anëtar 7. Shefqet Mehmetukaj – anëtar 8. Erma Shishko – anëtare 9. Semra Mecihan – anëtare	Këshilli Drejtues, pas propozimeve të anëtarëve të Këshillit, miratoi komisionin për provim të rilicencimit në OFK me mandate 4 vjeçar duke kërkuar që të njejtit të dorëzojnë draftin e planprogramit për provim në Këshill deri me 01/03/2024 në këtë përbërje: Driton Shabani – Kryetar Arlind Daka – Grapci – Anëtare Alban Bakolli – Anëtar Eda Mehmeti – Anëtare Gëzime Pllana - Anëtare	
TOTAL	5. Këshilli Drejtues po ashtu miratoi planin për punën dhe financat 2024, Dizajnin e ID kartelave për sistem digjital, vazhdoi kontratën me kontabilistin sipas të njejtave kushte me vitin paraprak edhe për vitin 2024, krijoi komisionin për përzgjedhje të një pjestari në shërbim profesional të përbërë nga Taulant Bajrami, Jehona Hakaj dhe Erma Shishko	
Munguan ne takim	6. Këshilli autorizoi z. Shefqet Mehmetukaj si Kryesues të Këshillit Organizativ që së bashku me z. Astrit Haxhijaha, z. Amir Keka si anëtar dhe administratën të bëjë hulumtimet e nevojshme për organizim si hapësirat ku do të organizohet Hotelet, terminet kohore dhe çështjet tjera të nevojshme për organizim dhe në mbledhjet e radhës ti paraqes para Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues vendos unanimisht për organimin e konferencës në periudhen e preferuar	
	7. 31 Maj, 1 dhe 2 Qershorë në varëshmëri të hapësirave kohore të Hoteleve ku do të organizohen.	
	8. Pas sqarimeve nga abacous të kërkuara nga mbledhja e kaluar, Këshilli Drejtues vendosi të lidh kontratë për menaxhimin e platformës barnatoret kujdestare duke paguar shumën prej 30 euro në muaj. Kohëzgjatja e kontratës 6 mujore me mundësi vazhdimi	
	Këshilli Drejtues konfirmoi vendimin e marrë me votim qarkullues përmes së cilës është caktuar kompenzimi i punë për angazhimin në organizimin e konferencës “Strategjia Nacionale e Farmacisë – Vizioni 2030” në shumën prej 150 Euro për anëtrë.	
	Këshilli Drejtues po ashtu konfirmoi edhe dërgimin e z. Besim Azemi në komisionin për përcëktimin e cmimeve të produkteve medicinale	
	9.	

KËSHILLI MBIKQYRËS		DATË: 26/01/2024	
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA	
10.	Astrit Iljazi – Kryetar	KËSHILLI MBIKQYRËS miratoi raportet e punës për periudhen Dhjetor 2023 Këshilli Mbikqyrës unanimitisht pas shqyrtimit të raportit të punës së organeve të OFK-së për muajin Dhjetor 2023 miratoi unanimitisht raportin	
11.	Suada Halimi – anëtare		
12.	Teuta Rexhepi – anëtare		
13.	Jehona Zogaj – Anëtarë		
14.	Mentor Syla – Anëtarë		
TOTAL			
Munguan ne takim			

[illegible]

KOMISIONI PËR EVP		DATË: 19/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Demush Bajraktari 2. Shkumbin Spahija 3. Selvete Shuleta	Janë shqyrtuar 12 kërkesa për valorizim, 11 janë aprovuar dhe në 1 rast është kërkuar certifikata shtesë Janë shqyrtuar edhe aplikimet për akreditim si : Fahri Zaberxha B.I ‘Barnatore Tini Pharm- Përdorimi dhe Efektet e produkteve bimërore në farmaci Komisioni vlerësoi se ky aktivitet plotëson kriteret e parapara të Rregullores për Vlerësim si Takim Profesional , duke e vlerësuar me 3 pikë aktive 2 pike pasive	
TOTAL		
Munguan në takim	Ecra Pharm-Roli i farmacistit në ofrimin e kujdesit optimal të pacientit. Dhimbja dhe infeksionet e traktit respirator Komisioni vlerësoi se ky aktivitet plotëson kriteret e parapara të Rregullores për Vlerësim si Konferencë, duke e vlerësuar me 13 pikë aktive 10 pike pasive Qendra Kosovare Për Hulumtim Trajnim Dhe Zhvillim të Politikave Sociale dhe Shëndetësore Pas kërkesës së organizatoreve që aktiviteti i tyre të akreditohet me pike më të larta, komisioni e rishikoi përsëri këtë kërkesë dhe e vlerësoi prap me të njëjta piket Duke pasur parasysh që aktiviteti është i parapara me 4 module komisioni vlerësoi se ky aktivitet i plotëson kriteret si : Kurs i kategorisë I dhe II Moduli I-Kurs i kategorisë I- 5 pike pasive 10 aktive Moduli II-Kurs i kategorisë II- 3 pike pasive 6 aktive	

Moduli III- Kurs i kategorisë II- 3 pike pasive 6 aktive

Moduli IV-Kurs i kategorisë II- 3 pike pasive 6 aktive

Per secilen nga module organizatori ka obligim qe ta lajmron OFK-ne 5 dite me heret para organizimit, gjithashtu dhe per secilin modul te beje pagese ne shume prej 150 euro

Grupi punues për plotësim ndryshim të statutit		DATE: 11/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA
1. Qendrim Maloku	Grupi punues mbajti takimin konstituiv. U dakordua mënyra e punës, ku u vendos që fillimisht të kërkohet në fazë paraprake të konsultimit nga anëtarët e Kuvendit propozimet e tyre dhe pastaj të hartohet drafti për dorëzim në Këshill Drejtues. Grupi kërkojë që drafti i përcaktuar të dal në diskutim public dhe konsultim public për të paktën 15 ditë dhe pas marrjes së propozimeve të hartohet drafti përfundimtarë për dërgim në Kuvend.	
2. Vjosa Rexhepi		
3. Arta Vataj		
TOTAL		
Munguan ne takim		

Grupi punues për plotësim ndryshim të statutit		DATË: 25/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
4. Qendrim Maloku 5. Vjosa Rexhepi 6. Arta Vataj 7. Sulltane Havolli	Pas mbarimit të afati për konsultim paraprak me anëtarët e Kuvendit, grupi punues hartoi draftin e statutit të cilën ja propozoi Këshillit Drejtues për miratim dhe dërgim në fazën e konsultimeve publike me anëtarët e Odës dhe palët tjera të interest.	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Komisioni per cështje etike		DATE: 12/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Vjosa Rexhepi 2. Muhamet Sallova 3. Bashkim Sadiku	Shqyrtimi i kërkesës nga Donjetë Ahmetaj Komisioni pas shqyrtimi të kërkesës kërkoi nga ana e znj. Ahmetaj qe dosja te plotesohet edhe me shkresat ne fjale: 1. Aprovimi - leja nga institucioni ne te cilin do te realizohet hulumtimi 2. Consenti 3. Pytesorit (te dhenat qe kerkohen) te cili do ti nenshtrohen subjektet te cilat do te jene pjese e hulumtimit per te cilin eshte aplikuar. Shqyrtimi i kërkesës nga Saranda Sejdiu	
TOTAL	Komisioni pas shqyrtimi të kërkesës nga ana e znj. Sejdiu, kërkoi që dosja të plotësohet edhe me aprovimin e insitucionit ku do të realizohet hulumtimi në fjalë.	
Munguan ne takim		

Komisioni per cështje etike		DATË: 24/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Vjosa Rexhepi 2. Muhamet Sallova 3. Bashkim Sadiku	- U shqyrtua shtojcat përkatësisht përcaktimi i formularëve për aplikim dhe formularëve tjetër të nevojshme sipas rregullorës të cilat dërgohet - U aprovua pas plotësimit të dokumentacionit kërkesa e anëtarët Donjeta Ahmetaj Rexha - Për shqyrtimin ekërkesës së Kaltrina Zenunit u kërkuar dokumentacion shtesë respektivisht leja nga universiteti	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Këshilli Etik		DATË: 24/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
8. Sulltane Havolli 9. Adelina Surdulli 10. Teuta Balidemaj 11. Amir Keka	- U shqyrtuan 15 raporte të pranuar nga inspektoriati farmaceutik, nga të cilat në 3 raste u vendos të ftohen në seancë dëgjimore pranë Këshillit Etik	
TOTAL		
Munguan ne takim		

RAPORTI I PUNËS TË ORGANEVE TË OFK-SË SHKURT 2024

Këshilli Drejtues		DATE: 08/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Kadri Bytyqi - Kryetar 2. Jehona Hakaj – zv. Kryetare 3. Astrit Haxhijaha – zv. Kryetar 4. Fatos Aliu – Anëtar 5. Ismail Shurdhaj – anëtar 6. Jeton Gutaj – anëtar 7. Shefqet Mehmetukaj – anëtar 8. Amir Keka - Anëtar 8. Erma Shishko – anëtare 10. Semra Mecihan – anëtare	- Diskutimi mbi propozimin e statutit - Pas prezantimit të statute, Këshilli Drejtues vendos që të njejten ta shqyrtojë në një takim të veçantë 1. Organizimi i Kongresit Këshilli Drejtues vendosi të pranoi ofertën nga Klan Arena si ofertën më ekonomike dhe më të përshtatshme për kriteret e organizimit të kësaj conference Tema boshte e konferencës u përcaktua “Integrimi farmaceutik – sfidat legjislative “ Këshilli Shkencorë në unanimitet miratoi përbërjen e Këshillit Shkencorë prej : 1. Zehadin Gashi Kryetar 2. Dashnor Nebija 3. Jeton Gutaj 4. Lindita Aliaga 5. Mimoza Basholli 6. Rona Karahoda 7. UFSH Këshilli Organizativ u përcaktua në unanimitet në këtë përbërje : 1. Shefqet Mehmetukaj – Kryetar 2. Amir Keka – Zv. Kryesues 3. Astrit Haxhijaha 4. Driton Gashi 5. Dua Dana 6. Jehona Zogaj 7. Nderim Azemi	
TOTAL		
Munguan në takim		

8. Semra Mecihan

9. Suada Halimi

10. UFSH

Gjatë mbledhjes së këshillit drejtues u prezantuan edhe pregaditja vizuale e benficioneve për sponzorë në konferencë e bërë nga kompania e dizajnit që ishte angazhuar edhe në konferencën e kaluar ndërsa drafti i planit buxhetor për kongresë mbetet për shqyrtim në takimin e radhës.

Këshilli Drejtues në mënyrë unanime konfirmoi delegimet të cilat janë bërë mes periudhave nga takimi i fundit të Këshilli Drejtues përkatësisht z. Dashnor Nebija – Komisioni për regjistrim të produkteve pa paralele dhe Delegimet në UFSH – Zehadin Gashi dhe Nora Rrahimi Hasani – komitet shkencor ndërsa Adelina Surdulli dhe Teuta Balidemaj në komitetin organizativ

Këshilli Drejtues me unanimitet vendos të delegoj znj. Donjeta Ahmetaj Rexha në Komitetin për kontrollit të rezistencës antimikrobike dhe z. Mentor Shamolli në Komitetin për gatishmëri dhe reagim

Këshilli Drejtues në unanimitet miratoi kërkesën për bashkpunim të paraqitur nga Vllsapagesa.

Këshilli Drejtues në unanimitet miratoi kërkesën për lirim nga pikët kredituese për rilicencim si pasojë e gjendjes shëndetësore nga ana e anëtarës

Këshilli Drejtues		DATË: 23/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Kadri Bytyqi - Kryetar 2. Jehona Hakaj – zv. Kryetare 3. Astrit Haxhijaha – zv. Kryetar 4. Fatos Aliu – Anëtar 5. Ismail Shurdhaj – anëtar 6. Jeton Gutaj – anëtar 7. Shefqet Mehmetukaj – anëtar 8. Amir Keka - Anëtar 9. Semra Mecihan – anëtare	- U finalizua drafti i Statutit per dergim ne konsultim publik per 15 dite, si dhe u pajtuan per organizimin e degjimeve ne 7 rajone 11. Këshilli Drejtues përcakton datën e fundit për raportim të organeve për raportet e punës për vitin 2023, datën 10 Mars 2024 12. Këshilli Drejtues miratoi delegimet e ardhura nga UFSH Prof. Besnik Juca për këshill shkencor dhe Dr. Artida Pashaj në Këshill Organizativ. Gjithashtu u vendos ti kërkohet një përfaqësues për këshill shkencor dhe një për këshill organizativ AKPPM pasi në të gjitha organizimet e derimtanishme kanë pasë përfaqësues të tyre, 13. Taulant Bajrami në cilësinë e Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës për një anëtarë në shërbimin profesional njofton Këshillin Drejtues se tashmë procedurat e përzgjedhjes kanë përfunduar respektivisht testimi me shkrim dhe intervista verbale. Gjithashtu njofton se procedura është në fazën e ankesave dhe deri më tani nuk kanë pranuar asnjë ankesë. Nga tre kandidatë është përzgjedhur një candidate që ka pasë vlerësimin më të lartë	
TOTAL		
Munguan ne takim		

KËSHILLI MBIKQYRËS		DATË: 28/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Astrit Iljazi – Kryetar 2. Suada Halimi – anëtare 3. Teuta Rexhepi – anëtare 4. Jehona Zogaj – Anëtarë 5. Mentor Syla – Anëtarë 6. Driton Gashi – Anëtarë 30€	KËSHILLI MBIKQYRËS miratoi raportet e punës për periudhen Janar 2024 Këshilli Mbikqyrës unanimisht pas shqyrtimit të raportit të punës së organeve të OFK-së për muajin Janar 2024 miratoi unanimisht raportin	
TOTAL		
Munguan ne takim		

KOMISIONI PËR LICENCIM		DATË: 23/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Zehadin Gashi 2. Njomza Doci 3. Arta Vataj 4. Florinë Latifi 5. Valmir Kukiqi	- Anëtarësimet U shqyrtua dhe u miratua 27 kërkesa	
TOTAL	1. Licencimet U shqyrtua dhe u miratua 27 kërkesë	
Munguan ne takim		
	2. Rilicencimet Jana aprovuar 9 kërkesa për rilicencim	

KOMISIONI PËR EVP		DATE: 16/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Demush Bajraktari 2. Shkumbin Spahija 3. Selvete Shuleta 4. Durim Ramadani	Janë shqyrtuar 13 kërkesa për valorizim, 1 është kerkuar shtese Akreditimet : 3. Rishqyrtim i aktivitetit Përdorimi dhe efektet e produkteve bimore ne farmaci me c’rast aktiviteti u vleresua me 8 pike per pjesmarres aktiv dhe 5 pasive 4. U miratua kerkesa nga ECRA Pharm per shtyerje te aktivitetit	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Komisioni per edukim specialistik		DATË: 27/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Ismail Halili 2. Gezime Pllana 3. Sofije Balaj 4. Besnik Stavileci	5. U mbajt konstituimi i komisionit 6. U ngriten shqetësimet në lidhje me përfshirjen e profileve të Biokimisë në fushën e specializimeve për farmacistë duke dhënë shembuj nga shtetet tjera	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Keshillo Organizativ		DATE: 24/01/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Sehfaqet Mehmetukaj – 2. Driton Gashi - 3. Jehona Zogaj - 4. Semra Mecihan - 5. Amira Keka - 6. Dua Dana – 7. Suada Halimi - 8. Astrit Haxhijaha	1. U konstitua Keshilli Organizativ 2. U percaktua grupi i ngushte qe do te merret me kontaktin me sponzore ne perberje prej Astrit Haxhijaha, Driton Gashi, Dua Dana, Nderim Azemi dhe Suada Halimi 3. U miratuan benefitet per sponzore 4. U vendos per kuotizimet pjesmarrja e rregullt 50 €, pjesmarrja e rregullt + gala 80€, pjesmarrja vetem ne gala 30€ 5. U vendos te behet koncepti i prezantimit per sponzore me kompanine qe ka qene e angazhuar edhe ne dhjetor Bling 6. U propozuan kontatet per gala mramje me kontaktet me Aurela Gace, Yllka Kuqi, Albina Kelmendi, Irma Libohova, Labinot Tahiri e Dafina Zeqiri	
7.		
Munguan ne takim		

Këshilli Etik		DATË: 16/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Sulltane Havolli 2. Adelina Surdulli 3. Teuta Balidemaj 4. Amir Keka 5. Gazmend Demiri	8. U mbajten seancat dëgjimore me palët e ftuara nga takimi paraprak	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Komisioni per konkurs		DATË: 5 Shkurt, 12 Shkurt dhe 15 Shkurt
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Taulant Bajrami 2. Jehona Hakaj 3. Erma Shishko	5 Shkurt – Vleresimi i aplikacioneve dhe caktimi i dates per test 12 shkurt- Hartim dhe vleresimi i testit me shkrim si dhe percaktimi i dates se intervistes 15 Shkurt – Intervistat se bashku me vendimin e perzgjedhjes Edona Kurtaj	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Keshilli Shkencor		DATE: 13/02/2024	
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA	
4. Zehadin Gashi	Këshilli Shkencorë pas shumë diskutimeve u dakordua për çështjet e mëposhtme : 9. Zgjerimin e fushave të përfshira në ftesën e hapur për dërgim të abstrakteve, ashtu që secili anëtarë i Këshillit Shkencorë do të paraqes propozimet e tij në mbledhjen e ardhëshme 10. Ti kërkohet Këshillit Organizativ të përcaktojë benefitet që do të kenë ligjëruesit nga jashtë Kosova si dhe ligjëruesit e tjerë 11. Të përcaktohen afati i fundit për dërgimin e abstrakteve të punimit 12. Këshilli shkencorë të hartojë rregullat të cilat duhet të përmbajë abstakti si dhe punimi i paraqitur nga anëtarët 13. Pas përcaktimit të pranimit të punimeve, Këshilli Shkencorë bënë ndarjen e kongresit në sesione në vartësi nga temat të cilat do të paraqiten si dhe të përcaktojë udhëheqësin e këtyre sesioneve 14. Këshilli Shkencorë përcakton kohëzgjatjen maksimale të prezantimit në kongres 15. Këshilli Shkencorë vendosë që në kongres të kenë mundësinë të paraqiten edhe poster prezantimet 16. Këshilli Shkencorë u dakordua të identifikojë autorët e mundëshëm për pjesëmarrje aktive në kongres.		
5. Jeton Gutaj			
6. Lindita Aliaga			
7. Mimoza Basholli			
8. Dashnor Nebija			
TOTAL			
Munguan ne takim			

Keshilli Shkencor		DATË: 21/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA
17. Zehadin Gashi	Këshilli Shkencorë u përcaktua fusha e punimeve për kongres	
18. Jeton Gutaj		
19. Lindita Aliaga		
20. Dashnor Nebija		
TOTAL		21. U përcaktaun udhëzimet për autorët për punime
Munguan ne takim		22. U përcaktua afati për pranimin e abstrakteve
		.

Komisioni per provim		DATE: 07/02/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
23. Driton Shabani 24. Eda Mehmeti 25. Arlinda Daka 26. Alban Bakolli	27. U konstitua përbërja e re e komisionit për provim të rilicencimit i përcaktuar nga Këshilli Drejtues 28. U dakordua qe komisioni brenda datës 1 Mars të paraqes programin e provimit për miratim në Këshill Drejtues, pas analizimit të planit nga komisioni i mëparshëm .	
TOTAL		
Munguan ne takim		

RAPORTI I PUNËS TË ORGANEVE TË OFK-SË MARS 2024

Këshilli Drejtues		DATE: 21/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Kadri Bytyqi - Kryetar 2. Jehona Hakaj – zv. Kryetare 3. Astrit Haxhijaha – zv. Kryetar 4. Fatos Aliu – Anëtar 5. Ismail Shurdhaj – anëtar 6. Jeton Gutaj – anëtar 7. Shefqet Mehmetukaj – anëtar 8. Visar Ademi - Anëtar 8.Erma Shishko – anëtare 10. Semra Mecihan – anëtare	29. Unanimisht u votua drafti final i Statutit të Odës i cili u dërgua për aprovim në Kuven si dhe u shqyrtuan komentet e pranuar gjatë fazës së konsultimit publik u pranuan vetëm komentet e paraqitura nga z. Edon Mucaj në lidhje me ndërprerjen e anëtarësimit dhe unifikimin e teksitit në vend të Oda me OFK 30. U miratua raporti i punës dhe ai financiar për vitin 2023 31. U miratua lirimi nga pagesa e anëtarëve të cilët anëtarësohen për herë të parë për atë vitë kur përfundojnë edhe provimin 32. U miratua lirimi nga ½ e pikëve kredituese për anëtarët të cilët arrijnë moshën 65 vjet dhe detyrimi i pagesës për anëtarësim 33. U vendos të organizohet Kuvendi i rregullt me 30 Mars si dhe u përcaktua rendi ditës për atë takim 34. U vendos për kthimin e përgjigjjes z. Armend Zemaj për qasje në dokumente publike 35. U njoftua për rekomandimin e grupit punues për barnatoret e Prishtinës.	
TOTAL		
Munguan ne takim		

KËSHILLI MBIKQYRËS		DATË: 29/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA
36. Astrit Iljazi – Kryetar	KËSHILLI MBIKQYRËS miratoi raportet e punës për periudhen Shkurt 2024 Këshilli Mbikqyrës unanimisht pas shqyrtimit të raportit të punës së organeve të OFK-së për muajin Shkurt 2024 miratoi unanimisht raportin	
37. Suada Halimi – anëtare		
38. Teuta Rexhepi – anëtare		
39. Jehona Zogaj – Anëtarë		
40. Mentor Syla – Anëtarë		
41. Driton Gashi – Anëtarë		
TOTAL		
Munguan ne takim		

KOMISIONI PËR LICENCIM		DATË: 19/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Zehadin Gashi 2. Njomza Doci 3. Arta Vataj 4. Valmir Kukiqi	- Anëtarësimet U shqyrtua dhe u miratua 4 kërkesa	
TOTAL	42. Licencimet U shqyrtua dhe u miratua 13 kërkesa	
Munguan ne takim		
	43. Rilicencimet Jana aprovuar 3 kërkesa për rilicencim	

[illegible]

KOMISIONI PËR EVP		DATË: 08/03/2024	
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA	
1. Demush Bajraktari 2. Shkumbin Spahija 3. Selvete Shuleta 4. Durim Ramadani		Janë shqyrtuar 12 kërkesa për valorizim, 1 është kerkuar shtese Akreditimet : 45. Farmacia e ushqimit-Roli i edukimit nutricional ne farmaci Komisioni pas shyrtimeve te aplikacionit vleresoj se ky aktivitet plotëson kriteret e parapara te Rregullores per Vlerësim si Konference dhe Ëorkshop , duke e vleresuar me Ëorkshopin me 6 pikë aktive 3 pike pasive Konferencen 12 pikë aktive 15 pike pasive 17 ligjeruesit Per secilin kures duhet qe te behet pagesa e veqant.	
TOTAL			
Munguan ne takim			

Komisioni per ceshtje etike		DATË: 12/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
46. Vjosa Rexhepi – 47. Bashkim Sadiku - 48. Muhamet Sallova -	Pika I-rë. Shqyrtimi i kërkesës nga Kaltrinë Zenuni Pas plotesimit te dokumentacionit per kerkesen nga znj.Zenuni komisioni e aprovoj kerkesen. Pika II-të. Shqyrtimi i kërkesës nga Lirim Mustafa Komisioni pas shqyrtimi të kërkesës kërkoi nga ana e z.Mustafa qe dosja te plotesohet edhe me shkresat ne fjale: 1.Letren e informimit 2.Deklaraten e pajtimit 3.Si dhe pytesorin	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Keshilli Organizativ		DATË: 13/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Sehfqet Mehmetukaj – 49. Jehona Zogaj - 50. Semra Mecihan - 51. Suada Halimi - 52. Bashkim Sadiku – 53. Nderim Azemi - 54. Astrit Haxhijaha	1. U raportua mbi situaten me sponzore 2. U Percaktua forma e publikimeve te njoftimeve per rrjete sociale 3. U more persiper ndarja e sponzoreve per kontakte dhe vizitia 4. U percaktuan detyrat e reja ne lidhje me akomodimet dhe ceshjet tjera organizative	
5.		
Munguan ne takim		

Prokurori i Odës		DATË: 14/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
55. Habib Luma	Shqyrtimi dhe vendosja ne lidhje me rastin e paraqitur nga Genti farm – hudhet poshte 1. Shqyrtimi i ankeses nga z. Gzonit Salihaj – u kerkuan certifikata shtesë	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Keshilli Shkencor		DATE: 20/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA
56. Zehadin Gashi	Këshilli Shkencorë pas shumë diskutimeve u dakordua për çështjet e mëposhtme : 1. Krijimi i templatit për prezantimin e ligjërueseve 2. Angazhimin për identifikimin e ligjëruesve të mundshëm në kongres	
57. Jeton Gutaj		
58. Lindita Aliaga		
59. Dashnor Nebija		
TOTAL		
Munguan ne takim		

Komisioni për buxhet dhe financa		DATË: 20/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
60. Besnik Nura 61. Kaltrina Haxhijaha 62. Agon Fazliu	Komisioni për buxhet dhe financa shqyrtoi dhe miratoi raportin financer për vitin 2023.	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Komisioni per provim		DATË: 06/03/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
63. Driton Shabani 64. Eda Mehmeti 65. Arlinda Daka	66. Komisioni u dakordua që të vazhdojë me programin e njejtë 67. Qe të përditësohet në vazhdimësi ky program 68. Ribotimin e librit të pyetjeve	
TOTAL		
Munguan ne takim		

RAPORTI I PUNËS TË ORGANEVE TË OFK-SË PRILL 2024

Këshilli Drejtues		DATE: 21/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Kadri Bytyqi – Kryetar 2. Jehona Hakaj – zv. Kryetare 3. Astrit Haxhijaha – zv. Kryetar 4. Fatos Aliu – Anëtar 5. Ismail Shurdhaj – anëtar 6. Jeton Gutaj – anëtar 7. Shefqet Mehmetukaj – anëtar 8. Visar Ademi - Anëtar 9. Amir Keka - Anëtarë 10. Erma Shishko – anëtare 11. Semra Mecihan – anëtare	69. Këshilli Drejtues shqyrtoi kërkesen e paraqitur nga Prof.Dr. Arlinda Daka Grapci, duke vendosur që mbështetje financiare do të ofrojë vetëm sipas konkursit të publikuar në fund të vitit ku ftohen të gjithë anëtarët të aplikojnë dhe jo sipas kërkesave individuale 70. Kërkesa për dorëzimin e raporteve të TM1 për vitin 2024 për organet e OFK-së, Këshilli Drejtues ofroi datën 10 Maj si datë të fundit për dorëzimin e këtyre raporteve 71. Pregaditjet përfundimtare për organizimin e kongresit të OFK-së, në këtë pikë Kryetari i Këshillit Organizativ informoi për rrjedhen e procesit të deritanishëm të këtij kongresi.	
TOTAL		
Munguan ne takim		

KËSHILLI MBIKQYRËS		DATË: 29/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA
72. Astrit Iljazi – Kryetar 73. Suada Halimi – anëtare 74. Teuta Rexhepi – anëtare 75. Jehona Zogaj – Anëtarë 76. Mentor Syla – Anëtarë 77. Driton Gashi – Anëtarë		KËSHILLI MBIKQYRËS miratoi raportet e punës për periudhen Mars 2024 Këshilli Mbikqyrës unanimisht pas shqyrtimit të raportit të punës së organeve të OFK-së për muajin Mars 2024 miratoi unanimisht raportin
TOTAL		
Munguan ne takim		

KOMISIONI PËR LICENCIM		DATË: 29/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Zehadin Gashi 2. Njomza Doci 3. Arta Vataj 4. Valmir Kukiqi 5. Florianë Latifi	- Anëtarësimet U shqyrtua dhe u miratua 1 kërkesa	
TOTAL	78. Licencimet U shqyrtua dhe u miratua 6 kërkesa	
	79. Rilicencimet Jana aprovuar 10 kërkesa për rilicencim	

Komisioni per edukim te vazhdueshem professional		DATE: 19/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
80. Demush Bajraktari – 81. Shkumbin Spahija - 82. Selvete Shuleta - 83. Durim Ramadani -	Shqyrtoi dhe miratoi 13 kërkesa nga valorizimet Rishqyrtoi kërkesen nga Qendra Kosovare për hulumtim trajnim dhe zhvillim të politikave sociale dhe shëndetësore dhe qëndroi pranë vlerësimit fillestar të saj	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Këshilli Organizativ		DATË: 08/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Sehfgjet Mehmetukaj – 84. Jehona Zogaj - 85. Semra Mecihan - 86. Suada Halimi - 87. Bashkim Sadiku – 88. Nderim Azemi - 89. Astrit Haxhijaha	1. U raportua mbi pregaditjet e deritanishme 2. U ndanë punët në lidhje me pritjen e musafirëve dhe punët tjera teknike 3. U raportua mbi kontaktet me sponzorë të takimeve	
4.		
Munguan ne takim		

Këshilli Shkencor		DATË: 17/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
1. Zehadin Gashi 2. Jeton Gutaj 3. Lindita Aliaga 4. Dashnor Nebija	a. Këshilli shkencorë diskutoi kriteret për abstrakte dhe shqyrtoi rrjedhën e deritanishëm të organizimit të aspektit shkencorë të kongresit	
b.		
Munguan ne takim		

Gjyqi i Nderit		DATE: 04/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës		PËRMBAJTJA
90.	Demush Bajraktari	Gjyqi i nderit shqyrtoi aktvendimin e gjykatës themelore të Prishtinës për përgjigje në padi. Gjyqi i nderit vendosi të paraqesë përgjigje mbi pretendimet e njejta që i ka paraqitur gjatë kërkesës për masë të përkohëshme duke i shtuar faktin se tashme z. Arianit Jakupi nuk është Kryetar i OFK-së dhe kjo detyrë ushtrohet nga anëtarë tjetër i Odës, rrjedhimisht vendimi i atakuar ka mbetur pa objekt të trajtimit.
91.	Ismajl Halili	
92.	Vjollca Limani	
93.	Besnik Basholli	
94.	Zgjim Balaj	
TOTAL		
Munguan ne takim		

Këshilli Etik		DATË: 05/04/2024
Anëtarët pjesëmarrës	PËRMBAJTJA	
